



Pranimi / Dorezuar Prapishen/Pre-dato Received/Delivery	14-01-9 2019	viti god year	
Organ/Rjeshtja Org./Jedinita Org./Unit	Pr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	Shtojca Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SRPM/SHCK	164/2019		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Anr. 788/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani- kryetar, Lela Petkovic dhe Malsore Gashi – Bajraktari - anëtar, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr.788/2018, të datës 29.12.2018, së ankuesja Lirije Muja, me adresë banimi rruga „Sami Gashi”, nr.133,nga Komuna e Mitrovicës, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës, në çështjen juridike “ kërkesë nga marrëdhënia e punës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 11.01.2019, mori këtë

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa A. Nr. 788/2018, e datës 29.11.2018, e parashtruar nga ankuesja Lirije Muja.
- II. **MBETET NË FUQI**. Vendimi Nr. 01-112/12-0052825-2/18, i datës 07.11.2018, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Mitrovicës.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.10.2018 ka nxjerr vendim , A. Nr. 582/2018, me të cilin ka detyruar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Komunën e Mitrovicës, që në afatin prej pesëmbëdhjetë (15), të bëjë rishqyrtimin e ankesës së ankueses të parashtruar nga Lirije Muja.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Mitrovicës, me datë 07.11.2018, me numër protokoll Nr. 01-112/127005825-2/18, ka nxjerr vendim me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar në ligj,

Ankuesja Lirije Muja, e pakënaqur me vendimin me nr. protokoll Nr. 01-112/127005825-2/18, datës 07.11.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Mitrovicës, brenda afatit ligjor me pajtim me Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 29.11.2018 me numër protokoll 7208//2018, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 788/2018, e datës 29.11.2018, me numër protokoll 7208/2018, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 07.11.2018, me numër protokoll Nr. 01-112/127005825-2/18, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Vendimi i datës 15.10.2018, A. Nr. 582/2018 Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimi i datës 24.07.2015: Përshkrimi i detyrave të punës; Ankesa e datës 06.07.2018, me numër protokoll 01-112/12-0052825/18, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Përgjigje në kërkesë e datës 18.06.2018; Përgjigje në kërkesë e datës 26.09.2018, me shkresat e bashkangjitura

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses Lirije Muja, **është e pa bazuar sepse:**


Kolegji për shqyrtimin e ankesave i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses, Lirije Muja, e cila pretendon se në përmbajtjen e akt emërimit, është e përfshirë vetëm „Sektori për Planifikim”, e cila është e punësuar në pozitën „Zyrtare për Buxhet dhe Financa”, me arsyetimin se nëpunësja civile duhet ti raportojë Drejtorit të Drejtorisë dhe kryen edhe pune tjera, jo vetëm të sektorit të Planifikimit, sipas përshkrimit të detyrave të punës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pretendimi i ankimore i ankueses, është në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 1 nen paragrafi 1.1,1.2, dhe nenin 2, të Rregullores Nr. 03/2010, për Përshkrimin e Detyrave të Punës, ku përcaktohet se: ***Me Aproximin e zyrtarit më të lartë Administrativ të institucionit përkatës, një përshkrim të përshkrim i detyrave të punës mund të ndryshohet dhe Plotësohet në rast të 1.1, Ndryshimin në numrin dhe Llojin e detyrave, 1.2 Ndryshimin të titullit të vendit të punës, ose të vendodhjes. 2. Udhëheqësi më i lartë administrativ në institucionin përkatës do të kërkojë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i pozitës që të përgatisë një version të ndryshuar të përshkrimit të detyrave të punës në bazë të standardeve të pacaktuara në këtë rregullore, si dhe të Propozojë një gradë për pozitën përkatëse në bazë të Rregullores për Klasifikim e vendeve të punës***”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se në bazë të shkresave të lëndës, përkatësisht përshkrimit të detyrave të punës del se në pikën 8, ankuesja është e sistemuar në kuadër të Sektorit për Planifikim, dhe se është në pajtim me Strukturën organizativë të Komunës së Mitrovicës, ku në kuadër të drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, është Sektor i Planifikimit, si dhe në bazë të Rregullores Nr. 02/2012, për Organizimin–Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses është edhe në kundërshtim me nenin 5, nen paragrafi 1.1 të Rregullores Nr. 03/2010, për Përshkrimin e Detyrave të Punës ku përcaktohet se; **Përshkrimi i detyrave të punës përdoret për; 1.1 Përcaktimin e vendosjes së punës në kuadër të Strukturës organizative të Institucionit të Administratës Publike.**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Mitrovicës, me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër 01-112/120052825-2 /18, të datës 07.11.2018, ka vepruar në pajtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me ankesën e ankueses Lirije Muja.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda Nr. A. Nr. 788/2018

Es'href SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses Lirije Muja;*
- *Kryetarit të Komunës së Mitrovicës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

